



Deklaratë e përbashkët e Organizatave Mjedisore

Tryeza e rrumbullakët: Projektligji ‘Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve’ në fokus të OSHC-ve

Menaxhimi i mbetjeve është një nga përparësitë kryesore të deklaruara nga Qeveria e Shqipërisë¹, sektor për të cilin janë ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e situatës në: a) anën legjislative, duke përfshirë atë me direktivat e BE dhe b) anën teknike, duke rritur territorin i cili mbulohet me shërbim, investuar në infrastrukturën e trajtimit të mbetjeve dhe zbatimin e nismave për monitorimin e pastrimit e vijës bregdetare, kryesisht gjatë periudhës së verës.

Qeveria Shqiptare ka miratuar në 2020 dy dokumente kryesore “*Dokumenti i Politikave Strategjike i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035*” (Dokumenti i Politikave Strategjike) dhe “*Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta*” (Plani Sektorial), të cilët përcaktojnë objektivat strategjike, synimet dhe infrastrukturën kryesore të nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Pavarësisht hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe ndërmarrjes së disa nismave nga ana e institucioneve me fokus kryesor ndërgjegjësimin, menaxhimi i mbetjeve në vend **mbetet ende një sfidë për Njësitë e Qeverisjes Vendore** të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimit në nivel vendor. Problemet lidhen kryesisht me zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve; mungesën e planeve për parandalimin dhe ripërdorimin e mbetjeve; ndërtimin e infrastrukturës për trajtimin paraprak e fundor të mbetjeve; hartimin e planeve rajonale/zonale; rritjen e ndërgjegjësimit për menaxhimin e mbetjeve; si dhe raportimi dhe monitorimi i të dhënave në lidhje me sasinë dhe tipologjinë e mbetjeve të gjeneruara, ricikluara për rryma të ndryshme të mbetjeve.

Me qëllim adresimin e problematikave në sektorin e mbetjeve Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer ndryshime ligjore të cilat kanë pasur në fokus uljen e përdorimit të qeseve njëpërdorimëshe dhe rritjen e masave ndëshkimore për subjektet të cilat nuk menaxhojnë si duhet mbetjet duke shkaktuar ndotje mjedisore. Në datë 20 gusht 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit hodhi për konsultim publik, në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, Projektligjin “*Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve*” i cili është i hapur për konsultim në portal deri më datë 17 shtator 2024.

Në mungesë të zhvillimit të një dëgjese publike të organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, OSHC-të mjedisore, përfaqësues të bizneseve të riciklimit dhe medias, në kuadër të projektit GreenAL (<https://greenal.al/>) zhvilluan një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar mbi këtë ndryshim legjislativ kaq të rëndësishëm në sektorin e mbetjeve në vend. Në përfundim të kësaj tryeze, Ne, 22 Organizata të Shoqërisë Civile, të organizuara në kuadër të projektit GreenAL, gjukojmë se ligji “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*” ka pasur nevojë për t’u riparë, koment që ka ardhur disa herë nga ekspertët e fushës e në disa raste, me qëllim respektimin e objektivave të vendosur në ligj, por edhe ndryshimin e qasjes duke aplikuar parimin ‘ndotësi paguan’ dhe ‘përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit’. Gjithashtu e vlerësojmë hapin e ndërmarrë nga Ministra për të përfunduar ligjin me Direktivën Kuadër të Mbetjeve, e cila ka qenë subjekt i disa ndryshimeve në vite, dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike duke përfshirë

¹ Siç përcaktohet nga ligji 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar



konceptin ‘zero mbetje’ me qëllim që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë e parë dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin dhe parimet e sistemit të ekonomisë qarkulluese. Megjithatë, Ne, mendojmë se një projektligj i cili **transformon në mënyrë rrënjësore menaxhimin e mbetjeve** në Shqipëri, **ka nevojë për një konsultim të mirëfilltë me grupet e interesit** nëpërmjet një procesi ndërveprues që lehtëson ndarjen e mendimeve për të siguruar gjithëpërfshirjen në vendimmarrje.

Referuar ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” projektligjet kanë detyrim të qëndrojnë për konsultim publik për të paktën **20 ditë pune**. Gjithashtu institucioni që propozon projektligjin mund të zhvillojë një dëgjese publike nëse e gjykon të arsyeshme për të përfshirë në diskutim grupet e interesit.

Nisur nga rëndësia dhe transformimet që ligji propozon në fushën e menaxhimit të mbetjeve, referuar VKM Nr. 584 datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, projektligji duhet të shoqërohet me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit, i cili gjithashtu duhet të jetë i hapur dhe i publikuar përgjatë konsultimit publik të aktit.

Referuar Nenit 6, Pika 1 të ligjit 146/2014 “Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik”, gjithashtu sipas pikës 2 të këtij neni “Organit publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara”.

Një nismë ligjore e tillë, siç është ndryshimi i plotë i qasjes ligjore të sektorit të menaxhimit të mbetjeve, nuk ka krahasim as me nismat e tjera, siç ishin:

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar², i cili u hap më datë 28.07.2022 dhe u mbyll më datë 28.12.2022. Ky projektligj qëndroi i afishuar në RENJKP për rreth 5 muaj, në të cilin u propozua ashpërsimi i kundërvajtjeve administrative me 30% të vlerës së gjobave, dhe u realizua gjithashtu një dëgjese publike në ambientet e MTE në datë 01.11.2022 ora 11:00 me pjesëmarrje të grupeve të interesit.
2. Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura””³, i cili u hap përsëri më datë 28.07.2022 dhe u mbyll më datë 28.12.2022, qëndroi i afishuar në RENJKP për rreth 5 muaj e gjithashtu u zhvillua edhe një dëgjese publike me grupet e interesit.

Në këto kushte lindin pyetjet:

- Përse për projektligjet e sipërpërmendura është zhvilluar një dëgjese publike, ndërsa për këtë projektligj jo?
- Përse projektligjit “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” hedhur për konsultim në datë 20 Gusht 2024, nuk i është dhënë e njëjta periudhë konsultimi si akteve të sipërpërmendura?

Gjithashtu nga grupet e interesit pjesëmarrëse në tryezën e rrumbullakët gjykohet se është i nevojshëm:

- Zhvillimi i një konsultimi publik, fizik e me bazë të gjerë, duke parë rëndësinë strategjike që ka ky projektligj për vendin dhe shoqërinë;

² <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/494>

³ <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/499>



- Përfshirja aktive të grupeve të interesit në rishikimin e ligjit dhe akteve nën-ligjore për të siguruar gjithëpërfshirjen në vendimmarrje;
- Përcaktimi i qartë të kompetencave të institucioneve të varësisë për të shmangur mbivendosjen e tyre, specifikisht ndërmjet AKM-së dhe AKEM;
- Përcaktimi i detyrave të monitorimit të subjekteve private dhe shtetërore, përcaktimi i lidhjes me Lejet Mjedisore si dhe të përcaktimi i detyrave të monitorimit për aktivitetet që nuk kanë një leje mjedisore.
- Marrja në konsideratë e kapaciteteve teknike dhe financiare të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për të zbatuar ligjin dhe respektuar objektivat e vendosur;
- Përcaktimi i një metodologjie të unifikuar për raportimin dhe monitorimin e sasisë dhe tipologjisë së mbetjeve të gjeneruara në vend, e cila do të mundësonte monitorimin e arritjes së objektivave të vendosura në ligj dhe Dokumentin e Politikave Strategjike;
- Në relacionin shoqëruar për ndryshimin e ligjit të argumentohet më qartë arsyeja e lejimit të importit të mbetjeve;
- Të përcaktohet qartë se cili institucion do të jetë përgjegjës për hartimin e planeve zonale dhe cilat janë hapat që do të kalojë dokumentacioni për të marrë miratimin final;
- Të përfshihen kriteret për përzgjedhjen e zonave ku do të instalohen facilitetet për trajtimin e mbetjeve, ose të referohet nëse këto do të përcaktohen në VKM.
- Të përfshihet në ligj neni 31 i Direktivës së mbetjeve 2008/98/EC e cila parashikon përfshirjen e publikut dhe grupeve të interesit në hartimin e planeve të menaxhimit dhe të parandalimit të mbetjeve;
- Të përcaktohet qartë se cili/cilat do të jenë institucionet të cilat do të jetë/jenë përgjegjës për ndërtimin e infrastrukturës së mbetjeve;
- Të hartohen plane për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve me qëllim zbatueshmërinë e aplikimit të hierarkisë së mbetjeve;
- Zhvillimi dhe bërja publike e një relacioni shterues i cili shpjegon përse u bë rishikimi i plotë i ligjit dhe çfarë nuk funksionoi në zbatueshmërinë e ligjit të 2011 dhe aktet nënligjore që e shoqërojnë atë;
- Rishikim të definicionit për mbetjet e rrezikshme shtëpiake të ngjashme me mbetjet spitalore dhe përcaktimi i saktë i rregullave për grumbullimin, transportin dhe asgjësimin e tyre;
- Përcaktim me të qartë të detyrimit të mospërdorimit të produkteve të plastikës njëpërdorimshme nga persona/individë, subjekte tregtare.
- Të rishikohet pjesa e gjobave, për ti lënë hapsirë parimit ndotësi paguan në raport me nivelin e dëmit të shkaktuar.

Si përfaqësues të shoqërisë civile jemi të ndërgjegjshëm për kontributin dhe rolin që duhet të kemi në proceset e Integritimit Evropian referuar “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim Evropian 2030”, dhe “Udhërrëfyesit për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile



2019 -2023". Në këtë drejtim shprehim gatishmërinë për të qenë pjesë aktive e diskutimit/eve për rishikimin e ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

Pjesëmarrësit në Tryezën e rrumbullakët për "Projektligjin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"

Tiranë, 13 Shtator 2024

